


Anketa e Turizmit Pushime dhe Udhëtime, 2021

Tiranë, më 14 Nëntor 2022: Anketa e Turizmit në Familje, “Pushime dhe Udhëtime” është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët mbi 15 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si dhe udhëtimet vajtje-ardhje, brenda dhe jashtë vendit.

Në vitin 2021, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi (brenda apo jashtë Shqipërisë) të kryera nga individët banues në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç ishte 3.459.499. Numri mesatar i netëve të qëndrimit për udhëtime të kryera është 4,3 netë. Udhëtimet për qëllime personale përbëjnë 97,1 % të udhëtimeve gjithsej, ndërsa udhëtimet për qëllime biznesi 2,9 % të tyre. Përqendrimet më të larta të udhëtimeve të kryera janë regjistruar në muajt: Gusht (18,6 %), Korrik (12,4 %), Qershor (11,5 %) dhe Dhjetor (9,9 %). Siç vërehet edhe nga grafiku shuma e netëve të qëndrimit (në milion) ka regjistruar vlerat më të larta në muajt Gusht, Korrik, Qershor dhe Dhjetor.

Fig.1 Numri i udhëtimeve dhe shuma e netëve të qëndrimit sipas muajit të nisjes, 2021, në milion



Udhëtimet sipas qëllimit


Në vitin 2021, janë regjistruar rreth 7,7% më shumë udhëtime në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, krahasuar me vitin 2020. Përgjithësisht është shënuar rritje për të gjitha llojet e udhëtimeve, ku rritja më e lartë është shënuar për udhëtimet për qëllime personale dhe biznesi jashtë Shqipërisë.

Tab.1 Shpërndarja e numrit të udhëtimeve sipas qëllimit, 2020 – 2021

Qëllimi i udhëtimit	2020		2021	
	Nr. udhëtime (në milion)	%	Nr. udhëtime (në milion)	%
Personale në Shqipëri	2,89	89,8	3,06	88,4
Personale jashtë Shqipërisë	0,28	8,9	0,3	8,7
Biznesi në Shqipëri	0,03	1,1	0,07	1,9
Biznesi jashtë Shqipërisë	0,01	0,2	0,04	1,0
Gjithsej	3,21	100	3,46	100


Në 2021, udhëtimet e kryera për qëllime "Vizita te të afërm dhe miq" në Shqipëri dhe jashtë saj janë rritur përkatësisht me 2,9 dhe 8,6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2020.

Fig.2 Shpërndarja sipas qëllimit të udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2020-2021, në %



Nëse do të analizojmë shpërndarjen e udhëtimeve sipas kohëzgjatjes së netëve të qëndrimit, udhëtimet e shkurtra (1-3 netë) në Shqipëri zënë një peshë më të madhe (70,0 %) se udhëtimet e gjata (4+ netë). Ndryshe paraqitet situata për udhëtimet e kryera jashtë Shqipërisë ku peshën më të madhe të tyre e zënë udhëtimet e gjata (69,8 %).

Fig.3 Shpërndarja e udhëtimeve sipas kohëzgjatjes brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2021, në %



Nëse do të analizojmë më në detaj kohëzgjatjen e udhëtimeve sipas qëllimit në Shqipëri dhe jashtë saj, vërejmë se udhëtimet për "Pushime dhe kohë të lirë" kanë kohëzgjatje të shkurtër brenda vendit (59,4 %) dhe kohëzgjatje të gjatë jashtë vendit (51,7 %). Udhëtimet për "Vizita të afërm dhe miq" kanë kohëzgjatje të shkurtër brenda vendit (79,9 %) dhe kohëzgjatje të gjatë jashtë vendit (83,2 %). Udhëtimet e kryera për qëllime biznesi kanë kohëzgjatje të shkurtër në Shqipëri (98,7 %) dhe të gjatë jashtë saj (77,0 %).


Tab.2 Shpërndarja e udhëtimeve sipas qëllimit, kohëzgjatjes brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2021, në %

Kohëzgjatja e udhëtimit	Në Shqipëri				Jashtë Shqipërisë			
	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita të afërm dhe miq	Biznes	Të tjera	Pushime dhe kohë e lirë	Vizita të afërm dhe miq	Biznes	Të tjera
Udhëtime të shkurtra	59,4	79,9	98,7	83,8	48,3	16,8	23,0	27,0
Udhëtime të gjata	40,6	20,1	1,3	16,2	51,7	83,2	77,0	73,0

Profili i udhëtarëve


Analizimi i udhëtimeve sipas grup-moshës në vitin 2021, na tregon se përqindjet më të larta të udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë janë kryer nga grup-mosha 25-34 vjeç.

Fig.4 Shpërndarja e udhëtimeve sipas grup-moshës brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2021 në %




Analizimi i udhëtimeve sipas gjinisë së udhëtarit, në vitin 2021, na tregon se përqindjet më të larta të udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë janë kryer më shumë nga udhëtarët meshkuj (52,0 % dhe 57,7%).

Fig.5 Shpërndarja e udhëtimeve sipas gjinisë brenda dhe jashtë Shqipërisë, 2021, në %



Lidhur me kohëzgjatjen e udhëtimeve të analizuar sipas grup-moshave të udhëtarëve, në vitin 2021, vihet re që udhëtimet me kohëzgjatje të shkurtër (1-3 netë) kanë shënuar përqindjen më të lartë për grup-moshën 45-54 vjeç. Ndërsa udhëtimet me kohëzgjatje të gjatë (4+ netë) janë kryer nga grup-mosha 75+ vjeç.


Fig.6 Shpërndarja e udhëtimeve sipas grup-moshës dhe kohëzgjatjes, 2021, në %



Udhëtimet sipas destinacioneve

Në vitin 2021, destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri janë qarqet: Tiranë (19,3 %), Vlorë (16,3 %), Korçë (14,1 %) dhe Durrës (11,3 %). Në udhëtimet e kryera jashtë Shqipërie përqindjet më larta janë regjistruar në: Greqi (2,3 %), Itali (1,8 %) dhe Turqi (1,3 %).

Fig.7 Përqindja e udhëtimeve sipas destinacioneve më të frekuentuara në Shqipëri dhe jashtë saj 2021, në %



Nëse do të analizojmë udhëtimet e kryera në Shqipëri përgjatë tremujorëve të shpërndara sipas qëllimit "Pushime dhe kohë e lirë", vihet re se në tremujorin e parë destinacion kryesor i udhëtimeve ka qenë qarku i Korçës me 31,4 %, ndërsa udhëtimet që kanë si destinacion kryesor qarkun e Durrësit kanë regjistruar përqindjen më të lartë të udhëtimeve në tremujorin e dytë 24,0 %, dhe për tremujorin e tretë është regjistruar si destinacion i preferuar qarku i Vlorës me 51,3 %. Edhe në tremujorin e katërt, udhëtimet me destinacion kryesor qarkun e Korçës kanë shënuar përqindjen më të lartë të udhëtimeve në përkatësisht 52,1 %.

Në vitin 2021, destinacionet më të preferuara të udhëtimeve të kryera jashtë Shqipërisë për "Pushime dhe kohë të lirë" për tremujorin e parë janë: Mali i Zi, Kosova, Turqia dhe Dubai, për tremujorin e dytë: Maqedonia e Veriut dhe Turqia, në tremujorin e tretë: Greqia, Turqia dhe Mali i Zi dhe për tremujorin e katërt: Turqia dhe Kosova.

Tab.3 Përqindja e udhëtimeve sipas destinacioneve më të frekuentuara brenda dhe jashtë vendit sipas tremujorëve për "Pushime dhe kohë të lirë", 2021, në %

Tremujori:	I parë	I dytë	I tretë	I katërt
Në Shqipëri				
Berat	1,8	1,0	0,6	0,7
Dibër	2,0	4,8	0,2	0,1
Durrës	16,1	24,0	18,4	10,6
Elbasan	2,8	0,6	1,0	2,4
Fier	2,1	0,5	1,1	-
Gjirokastrë	3,8	1,8	0,9	5,9
Korçë	31,4	13,5	9,5	52,1
Kukës	4,9	8,5	1,2	4,3
Lezhë	3,5	2,6	3,6	3,7
Shkodër	13,4	3,5	6,2	5,8
Tiranë	10,9	15,3	6,1	6,1
Vlorë	7,2	24	51,3	8,2
Jashtë Shqipërisë				
Greqi	5,5	3,6	36,5	6,8
Itali	2,4	-	6,5	0,6
Gjermani	-	8,6	-	2,3
Turqi	13,5	21,7	28,9	55,1
Spanjë	-	-	2,4	0,5
Egjipt	-	0,6	-	-
Dubai	11,5	1,8	-	0,3
Tailandë	-	-	-	4,3
Maldivë	-	-	-	1,9
SHBA	-	-	4,8	-
Kanada	-	-	-	-
Mal i Zi	46,0	7,4	12,8	4,9
Maqedonia e Veriut	3,9	43,9	6,3	8,6
Kosovë	17,3	12,5	1,8	12,0
Tjetër	-	-	-	2,7

Udhëtimet sipas llojit të akomodimit

Lloji më i shpeshtë i akomodimit në vitin 2021, është "të qëndruarit tek të afërmit apo miqtë", ndjekur nga kategoria "hotel" dhe "ambiente akomodimi me qira" apo "shtëpi ose apartamente të dyta për pushime". Në vitin 2021 vërehet rritje për kategorinë "shtëpi ose apartamente të dyta për pushime" rreth 1,4 pikë përqindje, ndërkohë ulje është regjistruar për kategorinë "qëndrim tek të afërmit ose miqtë" me rreth 3,4 pikë përqindje.

Fig.8 Shpërndarja udhëtimeve sipas llojit të akomodimit, 2020 - 2021, në %





Fig.9 Shpërndarja e udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë sipas llojit të akomodimit, 2021, në %



Numri i udhëtimeve të kryera nga udhëtarët për qëllime personale në Shqipëri dhe jashtë saj është rreth 3,36 milion për të cilët akomodimi më i preferuar është “qëndrimi tek të afërmit ose miqtë”. Numri i udhëtimeve të kryera për qëllime biznesi si në Shqipëri dhe jashtë saj janë rreth 0,1 milion dhe format më të shpeshta të akomodimit janë “qëndrimi tek të afërmit ose miqtë” dhe “hoteli”.

Tab.4 Shpërndarja udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë sipas qëllimit dhe llojit të akomodimit, 2021, në %

Qëllimi i udhëtimit:	Hotel	Shtëpi ose apartamente të dyta për pushime	Ambjente akomodimi me qira	Qëndrim tek të afërmit ose miqtë	Shtëpi pushimi, druri, kamping, (SPA, Ilixa) etj
Personale në Shqipëri	30,2	8,5	11,3	44,1	5,9
Personale jashtë Shqipërisë	34,8	7,2	6,7	50,2	1,1
Biznesi në Shqipëri	44,3	-	8,1	31,2	16,4
Biznesi jashtë Shqipërisë	26,9	-	24,0	28,1	21,1
Gjithsej	30,8	8,2	10,9	44,3	5,8

Për të gjitha llojet e udhëtimeve të kryera në Shqipëri shfaqen format të ndryshme të akomodimit në qarqe. Udhëtimet në të cilat janë regjistruar përqindjet më të larta të akomodimit në “hotel” kanë si destinacion qarkun Korçë dhe Vlorë, akomodimi në “ambiente me qira” është raportuar në udhëtimet që kanë si destinacion qarqet: Vlorë, Durrës dhe Korçë ndërsa për kategorinë “shtëpi apo apartamente të dyta” janë renditur destinacionet për qarqet si: Durrës, Korçë dhe Vlorë.

Tab.5 Shpërndarja e udhëtimeve brenda Shqipërisë dhe llojit të akomodimit, 2021, në %


Qarku	Hotel	Shtëpi ose apartamente të dyta për pushime	Ambiente akomodimi me qira	Qëndrim tek të afërmit ose miqtë	Shtëpi pushimi, druri, kamping, (SPA, llixha) etj
Berat	1,4	0,4	0,1	4,0	0,7
Dibër	0,9	2,1	0,6	7,7	7,2
Durrës	8,4	34,4	26,7	8,2	8,3
Elbasan	3,6	0,1	0,2	9,9	6,1
Fier	0,1	2,0	0,5	10,3	3,5
Gjirokastrë	2,0	7,8	1,0	1,2	1,3
Korçë	27,6	19,6	19,9	6,4	7,6
Kukës	4,8	3,3	2,8	2,3	1,6
Lezhë	2,7	0,4	4,8	5,4	5,0
Shkodër	7,3	2,5	2,8	5,3	11,2
Tiranë	14,8	8,5	8,5	33,7	6,5
Vlorë	26,3	18,8	32,1	5,5	41,0

Sa i përket udhëtimeve të kryera jashtë Shqipërisë, akomodimet në "hotel" paraqesin përqindjet më të larta për destinacionet si Turqi, Greqi dhe Mal i Zi. Akomodimi tek "të afërmit apo miqtë" paraqitet më shpesh në udhëtimet që kanë si destinacion Italinë dhe Greqinë.

Udhëtimet sipas llojit të transportit

Rreth 3,3 milionë udhëtime janë kryer nëpërmjet transportit rrugor të cilët përbëjnë 95,2 % të të gjithë udhëtimeve të kryera në vitin 2021. Rritja më e lartë është regjistruar në transportin rrugor nëpërmjet makinave private me 2,5 pikë përqindje.

Fig.10 Shpërndarja e udhëtimeve sipas mënyrës së transportit, 2020-2021, në %



Udhëtimet një ditore (vajtje-ardhje)

Nëse do të analizojmë udhëtimet një ditore sipas qëllimit (personale apo biznesi), vërehet se udhëtimet e kryera në Shqipëri në tremujorin e dytë dhe të tretë kanë shënuar numrin më të lartë të udhëtimeve për qëllime personale ndërsa në tremujorin e dytë dhe të parë udhëtimet për qëllime biznesi. Për sa i përket udhëtimeve për qëllime personale dhe biznesi jashtë Shqipërisë janë kryer më shumë në tremujorin e parë.


Tab.6 Shpërndarja e udhëtimeve një ditore (vajtje-ardhje) sipas tremujorëve dhe qëllimit, 2021

Tremujori	Shuma e udhëtimeve një ditore (vajtje-ardhje) (në nr.)			
	Për qëllime personale		Për qëllime biznesi	
	Në Shqipëri	Jashtë Shqipërisë	Në Shqipëri	Jashtë Shqipërisë
I	4.677.552	241.486	629.298	16.574
II	7.874.762	182.746	1.389.738	4.279
III	6.209.644	203.724	338.212	948
IV	5.958.287	128.918	464.105	3.070
Gjithsej	24.720.245	756.873	2.821.355	24.872

Vendi i origjinës së udhëtimeve

Rreth 33,8 % e udhëtimeve si brenda dhe jashtë vendit si vend origjinë kanë qarkun e Tiranës. Nga udhëtimet e kryera gjithsej në vitin 2021, vihet re se përqindjet më të larta për udhëtime me destinacion jashtë Shqipërisë kanë si origjinë qarqet e Tiranë, Fier dhe Durrës.

Fig.11 Shpërndarja udhëtimeve brenda dhe jashtë Shqipërisë sipas vendit të origjinës, 2021, në %



Metodologjia

Anketa e Turizmit në Familje. "Pushime dhe Udhëtime" është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri mbi 15 vjeç. Anketa mbledh të dhëna mbi udhëtimet me të paktën një natë fjetjeje për pushime, udhëtime pune dhe udhëtime të tjera, si brenda dhe jashtë vendit, gjithashtu edhe ato brenda ditës brenda/ jashtë vendit të ndarë në katër tremujorë përkatësisht: Tremujori i parë (Janar-Mars), tremujori i dytë (Prill-Qershor), tremujori i tretë (Korrik-Shtator), tremujori i katërt (Tetor-Dhjetor). Anketa e Turizmit në Familje, "Pushime dhe Udhëtime" u krye për herë të parë në vitin 2017 përgjatë gjithë vitit me një kampion përfaqësues për të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 2021, anketa e Turizmit në Familje, "Pushime dhe Udhëtime" u krye me një kampion prej 10.240 NjEF, ku për çdo tremujor anketa përfshin një kampion prej 2.560 familjesh ose 320 PSU.

Në përfundim të vërtimit u intervistuan rreth 7.654 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 74,7 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 8 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme.

Mbledhja e të dhënave:

Kryhet një interviste direkte nga anketuesit me pyetësor letër ku përfshihen pyetje për familjen dhe të dhënat bazë në lidhje me të si dhe realizohet intervistë individuale për çdo person prezent në NjEF mbi 15 vjeç.

Struktura e pyetësorit:

- Informacion i përgjithshëm;
- Karakteristikat demografike të anëtarëve të NjEF-së;
- Pyetësori Individual (karakteristika socio-demografike. numri dhe karakteristikat e udhëtimeve me fjetje dhe udhëtimet një ditore).

Përkufizime:

Turizmi është veprimtaria e vizitorëve duke ndërmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vend-banimit të zakonshëm ku jeton, për më pak se një vit, për çfarëdo qëllimi kryesor, duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekti rezident në vendin e vizituar.

Vizitor është klasifikuar një turist (ose vizitori për një ose më shumë netë), në qoftë se udhëtimi i tij / saj përfshin një qëndrim me fjetje.

Vizitor një ditë është një udhëtar ose turist i cili nuk qëndron gjatë natës në vendin ku ka udhëtuar.

Udhëtar do të konsiderohet individi i cili lëviz në vendeve të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje.

Udhëtimi i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.

Turizëm i brendshëm përfshin aktivitetet e një vizitori rezident brenda vendit.

Turizëm i jashtëm përfshin aktivitetet e një vizitori rezident jashtë vendit të referencës.

Udhëtim për qëllime personale: Udhëtime për qëllime personale janë ato udhëtime jashtë vend-banimit të zakonshëm të individit. të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj.

Udhëtim për qëllime biznesi ose pune: Udhëtime për qëllime biznesi janë ato udhëtime jashtë vend-banimit të zakonshëm të individit. të cilat përfshijnë të paktën një ose më shumë netë dhe nuk i kalojnë 12 muaj (kongrese dhe konferenca. panairë dhe ekspozita. bisedime për biznes dhe misione (shitje ose blerje). udhëtime profesionale (të ndërmarra nga përfaqësuesit e kulturës apo religjionit. etj), trajnimin, shoqërimin e personave të tjerë. etj).

Destinacioni kryesor: në rastin e një udhëtimi jashtë vendit. individi deklaron se ku ka qëndruar. Në qoftë se udhëtari nuk është në gjendje për të vendosur. udhëtari do vendosë si destinacionin kryesor vendin ku ai ka shpenzuar kohën më të madhe të netëve të qëndrimit; në qoftë se ka shumë vende me numër të njëjtë të qëndrimeve me fjetje atëherë do vendoset destinacioni më i largët apo vendi ku udhëtari ka shpenzuar më shumë para.

Netët e qëndrimit: janë netët e qëndrimit në një hotel ose ambijent i ngjashëm. në një banesë private me qira ose jo me qira (akomodimi ofrohet nga miqtë apo të afërmit), ose në natyrë (kamping). Gjithashtu në netët e qëndrimit janë të përfshira netët e kaluara në mjetet e udhëtimit (në tren, autobus).

Kohëzgjatja e udhëtimit: Numri i netëve të qëndrimit.

Qëllimi kryesor i udhëtimit: Qëllimi kryesor i udhëtimit është ai që i përshtatet më mirë sipas të intervistuarit. Është shumë e rëndësishme që të veçohen udhëtimet për qëllime personale nga ato për biznes ose punë.